



MANUAL PËR KONTRIBUTET

Mars 2014

SIGURIMI I FERMERËVE

I. Kushtet për t'u siguruar.

Mbështetur në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, të ndryshuar, personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të ketë mbushur moshën 16 vjeç;
2. Të jetë i/e aftë për punë;
3. Çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension;
4. Nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;
5. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi duhet:
 - Të banojë në të njëjtin nënqark ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale;
 - Të banojë në fshat, megjithëse tokën mund ta ketë në nënqarkun fqinjë.

II. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

1. Sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm.
2. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2013 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 30 000 lekësh.
3. I e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2013 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 23 000 lekësh.
4. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat rurale, nga data 01.01.2014 e në vazhdim paguan kontributet e sigurimeve shëndetësore në masën 3.4% të dyfishit të pagës mujore minimale prej 4 200 lekësh, të barabartë me 286 lekë në muaj.
5. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkarisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht, një herë në tre muaj.
6. Afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.
7. Njihen periudha sigurimi edhe periudhat e përcaktuara në pikën 6.1, Kreu IV, VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, të ndryshuar.
8. Për të bërë sigurim për periudha të kaluara, llogaria bëhet kundrejt masave të kontributeve të viteve respektivë, mbi të cilën aplikohen dhe kamatëvonesat përkatëse.

III. Përfitimet që rrjedhin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit në bujqësi.

1. *Kuotat e ulta të pagesave të kontributeve për sigurimin shoqëror, si rrjedhojë e politikave favorizuese shtetërore.*
 - Për një vit vjetërsie në punë në shtet një i/e vetëpunësuar në qytet paguan 68 037 lekë, ndërsa i/e vetëpunësuar/a në zonat fushore paguan 30 000 lekë në vit.
 - I/e vetëpunësuar/a në zonat malore paguan vetëm 23 000 lekë në vit.
2. *Përfitim të vjetërsisë në punë, ku njohja e periudhave për të cilat janë paguar kontribute njihet vjetërsi në marrëdhënie pune me shtetin.*

3. *I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është përfitues/e, sipas rastit, i/e:*
- Pensionit bazë të pleqërisë;
 - Pensionit të pjeshëm të pleqërisë;
 - Pensionit të reduktuar të pleqërisë;
 - Pensionit të invaliditetit;
 - Pensionit të pjeshëm të invaliditetit;
 - Pensionit familjar.
 - Shpërblimin për lindje fëmije;
 - Të ardhurën për barrë lindje, që është e barabartë me shumën e kontributeve të paguara nga 01.10.1993 - 30.03.2010, 16 vjet e 3 muaj;
 - Duke u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi në zonën fushore, për 15 vjet, në masën prej 65 702 lekësh, përfitohet pension i pjeshëm pleqërie prej 4 404 lekë në muaj, dmth për 1 vit e 3 muaj pension pleqërie mund të merren ato çfarë janë paguar;
 - Zona malore paguan 42 702 lekë dhe përfiton pension të pjeshëm pleqërie në masën 4 404 lekë në muaj, pra për 10 muaj pension pleqërie merren ç'janë paguar.

IV. Dokumentacioni dhe procedurat për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi.

1. *I/e vetëpunësuar/a në bujqësi paraqet tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi të sigurimeve shoqërore këto dokumenta:*
- Çertifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjëndjes civile;
 - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të komunës ose bashkisë.

Ose

- Akt noterial, që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh, qiramarrje);
 - Në çdo rast, për sigurim të periudhave për vitin korrent si dhe për periudha të kaluara, do të paraqitet vërtetimi i lëshuar nga komuna, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari, bujqësore/blegtorale.
2. Inspektori i të vetëpunësuarve në bujqësi, pasi gjykon për plotësimin e kushteve për sigurim si i/e vetëpunësuar në bujqësi plotëson dokumentin tip "Urdhër veprim".
3. Për të bërë pagesën paraqitet ky dokument në zyrën postare ose në zyrën bankare. Me kryerjen e pagesës zyra postare lëshon dokumentin "Mandat arkëtimi", ndërsa me kryerjen e pagesës në zyrën bankare lëshohet dokumenti "Veprim arke", i cili konfirmon kryerjen e kësaj pagese.
4. Me dokumentin "Mandat arkëtimi" ose "Veprim arke" personi paraqitet për regjistrim tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ku ka marrë "Urdhër veprimin".
5. Këto dokumenta në asnjë rast nuk duhet t'i dorëzohen punonjësve të sigurimeve shoqërore. Ato janë personale.
6. Në fund të procedurës dhe pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore bëhet pajisja e detyrueshme me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

SIGURIMI VULLNETAR

Kush përfiton nga skema e sigurimit vullnetar?

Të gjithë shtetasit shqiptarë që:

1. Kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar;
2. Për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm;
3. Janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre;
4. Nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi.

Çfarë përfitohet nga skema e sigurimit vullnetar?

1. Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përfitues, sipas rastit, i:
 - Pensionit bazë të pleqërisë;
 - Pensionit të pjesshëm të pleqërisë;
 - Pensionit të reduktuar të pleqërisë;
 - Pensionit të invaliditetit;
 - Pensionit të pjesshëm të invaliditetit.
2. Personi i siguruar për vitin korent dhe që ka paguar kontribute deri në nivelin maksimal, pasi plotëson kushtet e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përfitues, sipas llogaritjeve, i:
 - Pensionit të pleqërisë mbi kufirin e pensionit bazë;
 - Dyfishit të pensionit bazë të pleqërisë.
3. Në sigurimin vullnetar, pasi janë plotësuar kushtet e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bën pjesë edhe pensioni familjar.

Cilat fusha mbulohen me sigurim vullnetar?

Me sigurim vullnetar mbulohen katër fusha të kësaj skeme:

- I. Sigurim vullnetar për vitin korent.
- II. Sigurim vullnetar për periudha të kaluara.
- III. Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura.
- IV. Sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

I. Sigurimi vullnetar për vitin korent.

Sigurim vullnetar për vitin korent mund të paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç, deri në arritjen e moshës për pension;
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e sigurimit të detyrueshëm;
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e të vetëpunësuarve në bujqësi;
- Nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.

Sa është masa e kontributit për sigurim vullnetar për vitin korent?

1. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar nga personi i interesuar, është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës për efekt kontributesh të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa.

2. Pagesa aktuale për një muaj sigurim vullnetar është 4 110 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 19 026 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje:
 - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit Janar);
 - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar);
 - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar).
3. Por pagesat e vitit korent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 4 110 lekë, deri në pesëfishin e saj.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për vitin korent:

- Pensione bazë pleqërie, invaliditeti dhe familjar;
- Pensione më të larta se niveli bazë, sipas llogaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

II. Sigurim vullnetar për periudha të kaluara.

Kush mund të paguajë sigurim vullnetar për periudhat e kaluara?

1. Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.
2. Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve pasuniversitare.
3. Shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar.
4. Personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare mund të bëjnë sigurim vullnetar për mbulimin e periudhave të kaluara nga data 01.01.1994 deri në datën që kanë lënë shtetësinë.

Sa është masa e kontributit për sigurim vullnetar për periudhat e kaluara?

1. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa (aplikohet masa që është në fuqi në momentin e kryerjes së pagesës, masë e cila miratohet me VKM, për degën e pensioneve).
2. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 4 110 lekë për një muaj sigurim vullnetar. Kjo kuotë i korrespondon pagës minimale mujore: 19 026 x 21.6%. Në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për periudhat e kaluara:

- Vjetërsi pune, e cila influencon në plotësimin e kushteve për të përfituar një pension;
- Pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, në nivel minimal.

III. Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura.

Kush mund të paguajë sigurim vullnetar për më shumë të ardhura?

1. Të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
2. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korent.

Sa duhet të paguhet për sigurim vullnetar për më shumë të ardhura:

- a) Personat e vetëpunësuar - sigurohen me pagë minimale mujore 19 026 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguajnë kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, pra është sigurim me kuotë fikse 4 110 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote;
- b) Të punësuarit - sigurohen me pagë minimale mujore 19 026 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguajnë kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, pra sigurim me kuotë fikse 4 110 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote;
- c) Punëdhënësit - sigurohen me pagë minimale mujore 19 026 lekë ose shumëfishi i asaj mbi të cilin do të paguajnë kontributet dhe kjo pagë shumëzohet me 21.6%, dmth sigurim me kuotë fikse 4 110 lekë ose shumëfishi i kësaj kuote.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për më shumë të ardhura:

- Pensione bazë pleqërie, invaliditeti dhe familjar;
- Pensione më të larta se niveli bazë, sipas llogaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

IV. Sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

Kush mund të paguajë sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

1. Të vetëpunësuarit, të punësuarit dhe punëdhënësit.
2. Ky sigurim bëhet nga të vetëpunësuarit vetëm për vitin korent.

Përfitimet nga sigurimi vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

- Paaftësi të përkohëshme në punë. Periudha e përfitimit për paaftësi të përkohëshme në punë fillon në ditën e 15 të raportit mjekësor dhe zgjat jo më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të pagesës;

Si paguhet sigurimi vullnetar:

1. Personi i interesuar, paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendit ku ai banon dhe merr kontakt me inspektorin e sigurimit vullnetar.
2. Personi i interesuar duhet të ketë me vete dokumentat e mëposhtme:
 - a) Fotokopje të librezës së punës, ku pasqyrohen periudhat e sigurimit;
 - b) Fotokopje të librezës së kontributeve, në rast se e disponon;
 - c) Fotokopje të letërnjoftimit elektronik.
3. Nëse personi i interesuar bie dakort për t'u siguruar vullnetarisht, do të marrë dokumentin tip "Urdhër veprimi", i cili plotësohet nga inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore.
4. Duke disponuar këtë "Urdhër veprim" personi i interesuar paraqitet në bankë për të bërë pagesën. Me kryerjen e pagesës ai pajiset nga banka me "Mandat arkëtimi".
5. Pas marrjes së mandat arkëtimit, personi i interesuar rikthehet tek inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, me të cilin lidh marrëveshjen e sigurimit vullnetar, që nënshkruhet nga personi i interesuar dhe inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (mandat arkëtimi në asnjë rast nuk i dorëzohet punonjësit të sigurimeve shoqërore. Ai është personal dhe mbahet nga vetë personi i interesuar).
6. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, inspektori i sigurimit vullnetar të Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore është i detyruar të bëjë pasqyrimin në librezë të kontributeve të personit të interesuar, ose të hapë librezë të re nëqoftëse nuk ka.

Kush quhet person i vetëpunësuar?

Person i vetëpunësuar është personi i cili e ushtron vetë aktivitetin e tij dhe personi me të ardhura të rregullta nga veprimtaria ekonomike.

Çfarë janë dhe pse duhet të paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore?

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë pagesa të detyrueshme, për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, ku përfshihen edhe të vetëpunësuarit. Duke paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ju jeni i siguruar për të përfituar nga Ligji i sigurimeve shoqërore dhe nga Ligji i sigurimeve shëndetësore.

Ç'DUHET TË BËJMË PËR TË FILLUAR NJË BIZNES TË RI

Ku duhet të rregjistrohem nëse filloj një biznes të ri?

1. Përpara fillimit të veprimtarisë ekonomike dhe për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht, ju duhet të regjistroheni në Qendrën Kombëtare të Liçensimit (QKL). Më pas, ju duhet të paraqisni pranë Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm. Agjencia e Sigurimeve Shoqërore, mbështetur në këtë dokument, realizon regjistrimin tuaj në organet e sigurimeve shoqërore.
2. I vetëpunësuar, dy ditë pas regjistrimit në QKL, duhet të dorëzosh në organin tatimor listën e punonjësve të papaguar të familjes, me të cilët punon e bashkëjeton, formularin E-SIG 027/a "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna".

Si bëhet llogaritja e kontributeve?

- a) Të vetëpunësuarit dhe personat e papaguar të familjes që ushtrojnë veprimtari ekonomike, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, pensione dhe sigurim shëndetësor;
- b) Kontributet e sigurimeve shoqërore për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes, mbi 16 vjeç, që punojnë e jetojnë ligjërisht, llogariten mbi bazën e pagës mujore minimale, e cila duke filluar nga data 01.08.2013 e në vazhdim është 19 026 lekë në muaj;
- c) Për kontributet e sigurimeve shoqërore ju paguani 23% të pagës minimale mujore prej 19 026 lekësh, e barabartë kjo me 4 376 lekë në muaj;
- d) Për kontributet e sigurimeve shëndetësore ju paguani 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore 19 026 lekësh, pra 1 294 lekë në muaj.

Cilat janë afatet e pagesës së kontributeve?

- a) Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paguhen çdo tremujor, brenda datës 20 të muajit të parë, pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik. Pra jo më vonë se datat: 20 Prill, 20 Korrik, 20 Tetor, 20 Janar.
- b) *Kujdes:* Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, zbatohen penalitete.

Ku dhe si mund të paguhen kontributet?

- a) Ju mund t'i paguani kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në filialet e bankave të nivelit të dytë ose të postës shqiptare sha;
- b) Pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ju dhe pjestarët e familjes me të cilët ju punoni do të pajiseni nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Çfarë përfitohet si i vetëpunësuar nga pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

Nga pjesëmarrja në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfitohen të gjitha llojet e pensioneve:

- a) Pension bazë pleqërie;
- b) Pension i pjesshëm pleqërie;
- c) Pension pleqërie i reduktuar;
- d) Pension familjar;
- e) Pension invaliditeti;
- f) Pension i pjesshëm invaliditeti;
- g) Shërbim shëndetësor dhe rimbursim ilaçesh.

Kush quhet punëdhënës:

- a) “Punëdhënës” quhen të gjithë personat fizikë e juridikë, që punësojnë persona të tjerë me ose pa kontratë.

Cilat janë detyrimet si punëdhënës:

- a) Në mbështetje të Kodit të Punës punëdhënësi është i detyruar të nënshkruajë një kontratë pune me punëmarrësit, me kohë të plotë ose të pjesëshme;
- b) Punëdhënësi duhet të mbajë regjistra për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara për çdo punëmarrës, me kohë të plotë ose të pjesëshme;
- c) Të bëjë sigurimin e çdo punëmarrësi, me kohë të plotë ose të pjesëshme, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës ose në aktin e emërimit;
- d) Të bëjë llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, brenda afateve të përcaktuara për çdo punëmarrës.

Mbi ç’pagë duhet të llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo punëmarrës:

Paga bruto e punonjësve bëhet në mbështetje të pikës 1; Kreu II, të VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, të ndryshuar.

- a) Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore për çdo punëmarrës individual mbështetet në pagën bruto mbi kufirin e pagës minimale mujore, deri në kufirin e pagës maksimale mujore. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale;
- b) Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shëndetësore për çdo punëmarrës individual mbështetet në pagën bruto mbi kufirin e pagës minimale, pa kufi nga lart. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale;
- c) Paga bazë minimale mujore për punonjësit për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shkallë vendi është 22 000 lekë, ndërsa paga maksimale për sigurim shoqërore është 95 130 lekë.

Ku dhe si mund të rregjistrohesh për të filluar një veprimtari ekonomike.:

Përpara fillimit të veprimtarisë ekonomike dhe për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, së pari bëhet rregjistrimi në Qendrën Kombëtare të Liçensimit. Dy ditë pune pas rregjistrimit në QKL, dorëzohet pranë organit tatimor lista e të punësuarve, me pagën përkatëse, sipas formularit E-SIG 027/a “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna”.

Cila është procedura dhe afatet për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

- a) Paguesa e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kryhet nga punëdhënësi sipas afateve të përcaktuara me ligj. Dokumentat bazë për pagesën e tyre janë bashkangjitur në Aneksin e këtij Manuali;
- b) Punëdhënësi ka detyrim ligjor për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe masën e duhur. Listëpagesa është një deklaratë e subjektit, në të cilën evidentohen kontributet individuale, dhe si e tillë, në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, tatimpaguesi që nuk lëshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë me 10 000 lekë, për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar;
- c) Punëdhënësi, i cili nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën 48 orë përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të papaguara, detyrohet të paguajë edhe një gjobë 10 000 – 20 000 lekë për çdo rast;

- d) Punëdhënësi duhet të dorëzojë rregullisht sipas afatit të caktuar listëpagesat, të cilat janë i vetmi dokument, që vërteton pagesën e kontributeve për çdo punonjës;
- e) Listëpagesa është dokumenti bazë për dhënien dhe llogaritjen e përfitimeve për çdo punonjës, si dhe vërtetimeve të kërkuara prej tyre.

Si bëhet pajisja e punëmarrësve me librezat e kontributeve:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore pajis punëdhënësit me librezat e kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, sipas kërkesave që bëhen pranë këtyre organeve;
- b) Punëdhënësi i pajis të punësuarit me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe e plotëson çdo muaj, në datën e pagesës së pagës mujore.

Si duhen trajtuar përfitimet afatshkurtra:

- a) Mbështetur në Ligjin për sigurimet shoqërore, punëdhënësit duhet të llogarisin dhe të paguajnë për punëmarrësit e tyre përfitimet afatshkurtra, si për sëmundje ashtu edhe për barrëlindje;
- b) Kur punëmarrësi është i sëmurë ose përkujdeset për fëmijën e sëmurë, që ka në ngarkim, të vërtetuar me raporte mjekësore, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore deri në ditën e 14 me raport mjekësor deklarohen njëllëj sikur punëmarrësi të mos jetë i sëmurë dhe paguhet sipas përcaktimit në Kodin e Punës, ndërsa nga dita e 15 e raportit mjekësor punëmarrësi i siguruar ka të drejtë të marrë përfitime për paaftësi të përkohëshme nga fondet e sigurimeve shoqërore.

ANEKS MANUALI

A. PËR TË VETËPUNËSUARIT NË BUJQËSI

1. Në zonat malore përfshihen të vetëpunësuarit në bujqësi, që banojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë.
2. Në zonat fushore përfshihen të vetëpunësuarit në bujqësi, që banojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në rrethet Berat, Kuçovë, Durrës, Krujë, Elbasan, Peqin, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Korçë, Pogradec, Devoll, Lezhë, Laç, Shkodër, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Sarandë dhe Delvinë.

Masat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi, në zonën fushore dhe malore, për t'u paguar sipas viteve.

Nr.	Viti	Periudha	ZONA FUSHORE			ZONA MALORE		
			Gjithsej	Sigurim shoqëror	Sigurim shëndetësor	Gjithsej	Sigurim shoqëror	Sigurim shëndetësor
1	1993	Tetor-Dhjetor	405	405	0	243	243	0
2	1994	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
3	1995	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
4	1996	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
5	1997	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
6	1998	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
7	1999	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
8	2000	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
9	2001	Janar-Dhjetor	1,620	1,620	0	972	972	0
10	2002	Janar-Dhjetor	3,888	3,888	0	2,340	2,340	0
11	2003	Janar-Dhjetor	5,220	5,220	0	3,588	3,588	0
12	2004	Janar-Dhjetor	6,956	6,956	0	4,788	4,788	0
13	2005	Janar-Dhjetor	7,824	7,824	0	5,388	5,388	0
14	2006	Janar-Dhjetor	9,453	9,453	0	6,225	6,225	0
15	2007	Janar-Dhjetor	9,996	9,996	0	6,504	6,504	0
16	2008	Janar-Dhjetor	12,000	12,000	0	7,800	7,800	0
17	2009	Janar-Dhjetor	13,600	13,600	0	8,840	8,840	0
18	2010	Janar-Dhjetor	15,840	15,840	0	10,296	10,296	0
19	2011	Janar-Dhjetor	19,440	19,440	0	12,636	12,636	0
20	2012	Janar-Dhjetor	24,300	24,300	0	17,220	17,220	0
21	2013	Janar-Dhjetor	28,250	28,250	0	21,485	21,485	0
22	2014	Janar-Dhjetor	33,432	30,000	3,432	26,432	23,000	3,432
Periudha Tetor 1993-Dhjetor 2014			203,564	200,132	3,432	141,561	138,129	3,432

Shënim: Kontributi për sigurimin shëndetësor paguhet vetëm për vitin korent 2014.

A. PËR PUNËDHËNËSIT DHE TË VETËPUNËSUARIT

Baza ligjore mbi të cilën paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësit dhe të vetëpunësuarit:

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1251, datë 10.09.2008;
- VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, i ndryshuar;

- VKM nr. 55, date 03.02.2010, I ndryshuar;
- Udhëzim i Ministrit të Financave, nr. 26, datë 16.04.2009, i ndryshuar.

Llojet dhe përqindjet e kontributeve që duhet të paguhen për punëmarrësin

Në përqindje

Nr.	Degët e Sigurimit	Gjithsej %	Punëdhënës	Punëmarrës
1.	Dega e sigurimit të sëmundjes	0.30	0.18	0.12
2.	Dega e sigurimit të barrëlindjes	1.40	0.83	0.57
3.	Dega e sigurimit të pensioneve	21.60	12.79	8.81
4.	Dega e Sigurimit të aksidenteve e sëmundjeve profesionale	0.30	0.30	0.00
5.	Dega e sigurimit të papunësisë	0.90	0.90	0.00
6.	Shuma e sigurimit shoqëror	24.5	15.00	9.50
7.	Shuma e sigurimit shëndetësor	3.40	1.70	1.70
	TOTALI	27.90	16.70	11.20

Llojet dhe përqindjet e kontributeve që duhet të paguajë i vetëpunësuar

Në përqindje dhe në lekë

Nr.	Degët e Sigurimit	Përqindje (%)	Lekë
1.	Dega e sigurimit të barrëlindjes	1.40	266
2.	Dega e sigurimit të pensioneve	21.60	4,110
3.	Shuma e sigurimit shoqëror	23	4,376
4.	Shuma e sigurimit shëndetësor	3.4	1,294
	TOTALI	26.4	5,670

Dokumentat e deklarimit nëpërmjet formës elektronike për pagesat e kontributeve:

Për të realizuar pagesën e kontributeve, fillimisht duhet të futeni në Website e Tatimevedhe më pas në faqen tuaj, për deklarimin nëpërmjet formës elektronike të formularëve tip, që janë:

1. "Listëpagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi", - E-SIG 025/a2, e cila deklarohet nëpërmjet formës elektronike;
2. "Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore", - E-SIG 011-012/a, e cila deklarohet nëpërmjet formës elektronike;
3. Formulari i Urdhër-Pagesës për deklarimin elektronik të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
4. Për plotësimin e formularëve janë edhe udhëzimet përkatëse, pra: udhëzimi për plotësimin e listëpagesës dhe udhëzimi për plotësimin e formularit të deklarimit dhe të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore. Fillimisht do të plotësohet listëpagesa dhe më pas mbështetur në të dhënat e saj do të plotësohen formularët e deklarimit.

Për subjektet e biznesit të madh:

- Formulari E-Sig 025/a.1 – “Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi”, i cili deklarohet nëpërmjet formës elektronike në organin tatimor, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës;
- Formulari E-Sig 027/a – “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë e atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna”, i cili deklarohet nëpërmjet formës elektronike në organin tatimor, të paktën 48 orë përpara fillimit të punës së të punësuarve, që fillojnë punë për herë të parë, apo janë të punësuar rishtazi, si dhe brenda 10 ditëve për të larguarit nga puna.
- Formulari E-SIG 011-012/a “Formular i deklarimit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”;
- Formulari i Urdhër – Pagesës për deklarimin elektronik të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i cili shërben për realizimin e pagesave të kontributeve. Afati i pagesave është deri më date 20, të muajit pasardhës.

Për subjektet e biznesit të vogël:

- Formulari E-Sig 025/a.2 – “Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi”, i cili deklarohet nëpërmjet formës elektronike në organin tatimor, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës;
- Formulari E-Sig 027/a – “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë e atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna”, i cili deklarohet nëpërmjet formës elektronike në organin tatimor të paktën 48 orë përpara fillimit të punës të të punësuarve, që fillojnë punë për herë të parë, apo janë të punësuar rishtazi, si dhe brenda 10 ditëve për të larguarit nga puna;
- Formulari E-SIG 011-012/a - “Formular i deklarimit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”;
- Formulari i Urdhër-Pagesës për deklarimin elektronik të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i cili shërben për realizimin e pagesave të kontributeve, jo më vonë se data 20 e muajit të parë, pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, pra jo më vonë se datat 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 janar.